

Kontratë shërbimi

Aplikimi për shërbimet

Klientët që kërkojnë shërbime nga Albinspekt mund të aplikojnë duke paraqitur 9.1.002 Formularin e Aplikimit dhe 9.1.002_a Aneksi i formularit të Aplikimit për shërbimet t. Këto dokumenta plotësohen dhe firmosen nga klienti dhe i dërgohen Albinspekt në një nga mënyrat e mëposhtme: email, faks, nëpërmjet faqes së internetit, ose me postë).

Formulari i aplikimit është i publikuar në www.albinspekt.com.

Me paraqitjen e formularit të aplikimit dhe aneksit të plotësuar dhe firmosur, Albinspekt i dërgon klientit paketën informative.

Pas marrjes dhe vlerësimit të formularit të aplikimit, Albinspekt zbaton procedurën e tij të inspektimit dhe certifikimit.

1. Inspektimi dhe certifikimi

Albinspekt është i akredituar në bazë të ISO 17065 për zhvillimin e shërbimit të inspektim/certifikimit.

Ofrimi i shërbimit të inspektimit dhe certifikimit nga Albinspekt siguron besueshmërinë se produktet e certifikuar janë konform rregullave përkatëse dhe ligjeve shqiptare të aplikueshme.

Konsumatorët dhe klientët mund të besojnë në shërbimet e ofruara.

Në mënyrë që të sigurohet një cilësi sa më e mirë e procesit të inspektimit dhe zbatimit të rregulloreve të përzgjedhura në 9.1.002 Formulari i aplikimit për shërbimet, inspektimet kryhen në çdo vit (të paktën 1 herë në vit). Vendimi i certifikimit merret pas çdo inspektimi, dhe bazohet në gjetjet dala gjatë procesit të kontrollit. Vendimi i certifikimit mund të jetë pozitiv ose negativ, në varësi të plotësisë të kërkesave të rregulloreve, në njësinë subjekt certifikimi.

2. Tarifa e shërbimit dhe mënyra e pagesës

- Klienti do të informohet për tarifën e shërbimit nëpërmjet "Dokumentit të Tarifave" në momentin kur ai/ajo aplikon për inspektim/certifikim dhe gjithashtu është i publikuar në www.albinspekt.com.
- Në çdo rast, Klienti është i detyruar të informohet për "Tarifat" që në momentin e parë të aplikimit. Për këtë qëllim, Albinspekt do t'i informojë operatorët në mënyrë të përpiktë.
- Pagesat e tarifës do të kryhen në llogarinë bankare të Albinspekt, e cila i jepet Klientit.
- Faturat e lëshuara nga Albinspekt duhet të paguhet brenda afatit të caktuar. Klientit do t'i faturohen të gjitha kostot e njoftimeve për mospagesat, kosto të borxhit të akumuluar si dhe të gjitha kostot e tjera ligjore. Në rast mospagimi të këtyre borxheve, Albinspekt ka të drejtën të refuzojë ofrimin e mëtejshëm të shërbimeve si dhe të ndërpresë marrëdhënien kontraktuale menjëherë, pa lajmërim të mëparshëm.

3. Detyrimet e Klientëve nën skemën e kontrollit

Klienti subjekt i kontrollit nga Albinspekt (inspektim/certifikimi) me firmosjen e kësaj kontrate duhet të:

- Konfirmojë se është i njohur me rregulloret për të cilat kërkon shërbime nga Albinspekt (shih Formularin e Aplikimit) dhe do t'i zbatojë ato në të gjitha aktivitetet e njësisë së tij. Rregulloret më të fundit zbatohen në çdo kohë.
- Konfirmojë se pas marrjes së certifikimit, produktet e prodhuara në vazhdimësi do të përmbushin kërkesat e standardeve.
- Të sigurojë dokumentet e kërkuara nga sistemi i kontrollit dhe ti azhurnojë vazhdimisht ato.
- Ti japë akses stafit inspektues ose personave të autorizuar nga Albinspekt, në vendet e prodhimit, ndaj të dhënave të detyrueshme dhe dokumentacionit mbështetës (p.sh: dëftesave të shpërndarjes, faturave, etj.), personelit, pajisjeve dhe nën-kontraktorëve të klientit. Kjo zbatohet në të gjitha pjesët e njësisë, si nën skemën e certifikimit ose jo nën skemë, përfshirë të nën-kontraktuarit nëse Albinspekt e quan të rëndësishme për procesin e inspektimit dhe certifikimit. Inspektimet mund të ndodhin në çdo kohë.
- Të vërë në dispozicion të stafit inspektues të gjitha produktet dhe materialet me origjinë bujqësore/blegtorale dhe të gjithë përbërësit me origjinë bujqësore dhe jo bujqësore (duke përfshirë si pasojë, ujin, aditivët, aromatizuesit, etj) për analiza sipas kërkesave, për qëllim inspektimi dhe certifikimi.
- Ti japë mundësi trupës së kontrollit të shqyrtojë ankesat e marra. Të mbajë të dhëna mbi të gjitha ankesat e marra mbi produktet që janë subjekt inspektimi dhe certifikimi, të marrë masat e duhura dhe të dokumentojë masat e marra. Të marrë masat e nevojshme për sa i përket këtyre ankesave të marra si dhe mangësive të gjendura në produktet, të cilat ndikojnë përputhshmërinë me kërkesat e certifikimit; si dhe të dokumentojnë masat e marra.
- Të lejojë pjesëmarrjen e vëzhguesve në auditim nëse kërkohet.
- Të pranojë procedurat e kontrollit të Albinspekt duke përfshirë sistemin e sanksioneve dhe masat detyruese.
- Të paguajë çdo tarifë të Albinspekt në limitet kohore të caktuara.
- Të informoj për çdo ndryshim thelbësor në situatën e tij ose në çdo aktivitet të lidhur me sistemin e kontrollit dhe konformitetit të produktit, në limitet kohore të caktuara.
- Të mos tregtojë produktet me referenca ndaj certifikimit deri në ri-certifikimin e aktivitetit, për shkak të ndryshimeve të ndodhura në pikën (g) më sipër.
- Të zbatojë masat e rregullave mbi etiketimin e produkteve dhe Rregullat e referencës të certifikimit të Albinspekt (shih www.albinspekt.com), duke raportuar me përpikmëri çdo keqpërdorim, edhe nga operatorë të tjerë. Të sillt sipas udhëzimeve të Albinspekt me mediat, në lidhje me certifikimin e produktit (p.sh broshura, materiale promovuese ose reklama).
- Të bëjnë ekspozim të certifikimit vetëm kur i referohen, qëllimeve, synimeve, produkteve dhe vendeve të prodhimit për të cilat certifikata është lëshuar.
- Mos e përdorin certifikatën për të diskredituar Trupën e Certifikimit dhe të mos bëjnë vërejtje mbi certifikimin e

produkteve i cili mund të konsiderohet jo i saktë ose jo i

- o) Të sigurojë se kopjet e dokumenteve të çertifikimit, të cilat ju paraqiten të tjerëve, duhet të jenë kopje identike e të plota me origjinalin (të prodhuara në tërësinë e tyre).
- p) Në rast pezullimi ose tërheqjeje të çertifikimit,
 - Ndalohet përdorimi i të gjithë dokumenteve që përmbajnë referenca mbi çertifikimin dhe/ose ndalohet përdorimi, në rast tërheqjeje të çertifikimit, i materialeve reklamuese që përmbajnë referenca mbi çertifikimin. Çdo dokument kthehet me kërkesë të Trupës së Çertifikimit.
 - I komunikohen blerësve të produktit në formë të shkruar pasojat e ndëshkimit, në mënyrë që çdo tregues që i referohet çertifikimit të dhënë të fshihet nga ky produkt.
- q) Përdorin çertifikatën vetëm për të treguar që produktet janë çertifikuar sipas rregullave.
- r) Të bie dakort se autoritetet dhe trupat akredituese të lidhura me Albinspekt të kenë të njëjtin akses në ndërtesa dhe informacione si Albinspekt.
- s) Autorizojë Albinspekt për të nënkontraktuar shërbime, psh analiza për mbetje ose OMGJ.
- t) Të njoftojë Albinspekt menjëherë, me shkrim, faks apo e-mail, për ngjarjet që mund të përfaqësojnë një shkelje të mundshme të kërkesave të çertifikimit. Të pranojë pa paragjykime mundësinë për të bërë një ankim si dhe gjobat që aplikohen në përputhje me rregullat kombëtare, të Bashkimit Europian ose të Albinspekt, në fuqi.
- u) Kur kërkohet çertifikim dhe paraqitet njoftim për prodhim me metoda organike ndaj Albinspekt, duhet komunikuar:
 - emrin e çdo trupe kontrolli, subjekt i të cilit Klienti ka qenë më parë, dhe çdo penalizim të aplikuar nga trupa e mëparshme e kontrollit ndaj këtij Klienti.
 - në qoftë se njësia e prodhimit është në të njëjtën kohë subjekt ndaj një trupe tjetër kontrolli.
- v) Pas tërheqjes nga sistemi i inspektimit/çertifikimit të Albinspekt dhe/ose paraqitjes të një njoftimi të ri ndaj një trupe tjetër kontrolli, i duhet komunikuar trupës së re të kontrollit, çdo ndëshkim të aplikuar nga Albinspekt dhe ende në fuqi.
- w) Klienti është i detyruar të paguajë Albinspekt për shërbimet e tij sipas Tarifave të Albinspekt të publikuara në faqen www.albinspekt.com

4. Detyrimet e Albinspekt

Albinspekt do të:

- a) jetë përgjegjës për aktivitetet e tij të çertifikimit
- b) Konsiderojë konfidenciale të gjitha të dhënat dhe informatat rreth klientit të marra nga inspektimi dhe nga burime të tjera veç klientit
- c) mbajë pushtetin për vendimin e tij të çertifikimit, duke përfshirë dhënien, mirëmbajtjen, rinovimin, zgjerimin, reduktimin, pezullimin dhe tërheqjen e çertifikimit

5. Mirëbesimi

- a) Të gjitha të dhënat dhe informacioni që vjen nga njësia e Klientit dhe aktivitetet e tij/saj konsiderohen si konfidenciale. I gjithë stafi i Albinspekt i përfshirë në

autorizuar nga Trupi Çertifikues.

procesin e inspektim/certifikimit ka nënshkruar Deklaratën e Mirëbesimit të Albinspekt, e cila rregullon trajtimin e informacionit që inspektorët kanë marrë gjatë procesit të inspektimit.

- b) Ky nen nuk është i vlefshëm për autoritetet përkatëse për kryerjen e kontrollit të zbatimit të kërkesave sipas rregulloreve të mësipërme dhe/ose rregullave të akreditimit.
- c) Klienti lejon Albinspekt të publikojë çertifikatën (at) e tij/saj në faqen e internetit të Albinspekt.

6. Apelimet dhe ankesat

- a) Çdo klient ka mundësi të ankohet ose të apelojë vendimin e çertifikimit të marrë nga Albinspekt, brenda qëllimit të fushës së çertifikimit të ofruar.
- b) Çdo ankesë apo apelim duhet të paraqitet me shkrim pranë Albinspekt dhe do të trajtohet nga Komiteti i Apeliemeve.
- c) Ky Komitetit siguron besueshmërinë dhe paanshmërinë e sistemit të çertifikimit.

7. Dispozitat përfundimtare

- a) Çdo komunikim ndërmjet palëve kontraktore e lidhur me firmosjen e kësaj kontrate, përbushjen e detyrimeve të kësaj kontrate, realizimin e të drejtave që rrjedhin nga kjo kontratë do të kryhet me e-mail, postë ose fax.
- b) Çdo komunikim i marrë në format e përmendura në pikën a) më lart do të ketë të njëjtin efekt ligjor sikur komunikimi të ishte në formë të shkruar dhe ka të njëjtin efekt përpara gjykatave kompetente dhe autoriteteve të tjera publike.
- c) Kjo marrëveshje bëhet efektive pas nënshkrimit nga Aplikuesi dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme midis palëve që janë subjekt i saj. Kjo marrëveshje mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar. Çdo njëra nga palët mund ta përfundojë këtë marrëveshje me një paralajmërim prej 3 muajsh nga data e planifikuar mbarimit të saj. Të dyja palët rezervojnë të drejtën për ta ndërprerë kontratën për çështje serioze.
- d) Kjo marrëveshje do të mbarojë pa veprime të mëtejshme nëse klient shkel detyrimet dhe ose shkakton shkelje që mund ti shkaktojë dëme financiare Albinspekt-it. Në këtë rast, ai/ajo do të mbahet përgjegjës për të mbuluar këto dëme financiare.
- e) Nëse marrëveshja nuk anulohet përpara 31 Dhjetorit të çdo viti, Albinspekt planifikon automatikisht ofrimin e shërbimit për vitin pasardhës.
- f) Kjo kontratë është përpiluar në dy gjuhë (Shqip dhe Anglisht). Kjo kontratë rregullohet nga Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë dhe standardet përkatëse mbi të cilat Albinspekt ofron shërbimet e tij.
- g) të gjitha mosmarrëveshjet do të zgjidhen miqësisht midis palëve. Në të kundërt gjykata kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që rrjedhin nga zbatimi i kësaj kontrate do të jetë Gjykata e Rrethit Tiranë;



- h) Kjo kontratë nuk ka nevojë të jetë e nënshkruar nga Albinspekt sepse Albinspekt njih dhe pranon përmbajtjen e saj.

Data: ___/___/___

Klienti: _____
Emër, mbiemër, Firma